



## **Bashkimi Evropian Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve**

DEKLARATË PËR SHTYP: EUEOM/2013/11

### **Misioni i BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve prezanton raportin e tij përfundimtar dhe rekomandimet për zgjedhjet e ardhshme**

*Prishtinë, 6 mars 2014* – Pasi në deklaratat paraprake të tij i ka cilësuar zgjedhjet komunale të vitit 2013 në Kosovë si zgjedhje që paraqesin një hap të rëndësishëm përpara në konsolidimin e demokracisë, Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MBEVZ) sot i ka bërë publike gjetjet dhe rekomandimet e hollësishme të tij në mënyrë që të ndihmojë në përmirësimin e procesit zgjedhor në të ardhmen.

“Përkundër rrethanave sfiduese, zgjedhjet e para që janë mbajtur anekënd Kosovës, përfshirë edhe në veri, u zhvilluan në një atmosferë pozitive. Ishte inkurajuese të shihnim se si në çdo vend njerëzit po e ushtronin të drejtën demokratike të tyre për të votuar. Megjithatë, ne kemi vërejtur edhe disa çështje që duhet të trajtohen në të ardhmen,” tha Roberto Gualtieri, vëzhgues kryesor, derisa prezantonte raportin përfundimtar të këtij misioni në një konferencë për shtyp në Prishtinë. “Disa nga rekomandimet tona mund të realizohen që në zgjedhjet e përgjithshme të ardhshme, ndërsa për të tjerat do të kërkohet më shumë kohë që të jenë efektive. Është shumë me rëndësi që të konfirmohet trendi pozitiv që është vërejtur vitin e kaluar dhe që të sigurohemi që zgjedhjet e ardhshme të vazhdojnë të çojnë përpara zhvillimin demokratik të Kosovës”.

Raporti përfundimtar i MBEVZ ofron një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha aspekteve të procesit zgjedhor, gjegjësisht të kornizës ligjore, punës së administrimit të zgjedhjeve, regjistrimit të votuesve, votimit jashtë Kosovës, fushatës, ambientit mediatik, votimit dhe numërimit si dhe kontesteve zgjedhore. Duke u bazuar në vërtetimet e tij, MBEVZ i radhit, mes tjerash, rekomandimet e mëposhtme të cilat bazohen në standardet ekzistuese rajonale të përcaktuara nga OSBE-ja dhe Këshilli i Evropës:

- Të ndryshohet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) – dhe rrjedhimisht Ligji për Zgjedhjet Lokale (LZL) – në mënyrë që të inkorporohen aspektet kryesore të procesit të zgjedhjeve që aktualisht u janë lënë rregullave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ);
- Të azhurnohet dhe pastrohet regjistri civil, në mënyrë që listat e votuesve të jenë më të sakta;
- Të qartësohen në LZP kriteret që kanë të bëjnë me të drejtën për të votuar;
- Të rishikohet Rregulla e KQZ-së për votimin jashtë Kosovës;
- T’u jepen më shumë përgjegjësi Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ), veçanërisht lidhur me emërimin e Komisioneve të Vendvotimeve (KVV);
- Të përmirësohet komponenti i këtij procesi për edukimin e votuesve, duke shpjeguar më mirë se si të shënjohen fletëvotimet në mënyrë të duhur;
- Të bëhet tabelimi i rezultateve të zgjedhjeve lokale në nivelin komunal, duke i publikuar rezultatet e detajuara sipas vendvotimit;



## **Bashkimi Evropian Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve**

- Të zgjatet afati për parashtrim të ankesës në 48 orë, ndërsa afati për marrjen e vendimit nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) në katër ditë;
- Të përmirësohet pjesëmarrja e grave në procesin zgjedhor, duke siguruar një përfaqësim minimal (30 për qind) për secilën gjini në organet e administratës komunale;
- Të rregullohen më tej roli dhe kompetencat e Komisionit të Pavarur për Media (KPM) dhe të sigurohet funksionaliteti i plotë i tij gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

MBEVZ i ka diskutuar rekomandimet e tij me qeverinë, KQZ-në, partitë politike dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile si dhe me aktorët e tjerë kryesorë.

Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MBEVZ) ishte i pranishëm në Kosovë nga 4 tetori deri më 17 dhjetor të vitit 2013 si dhe gjatë zgjedhjeve të përsëritura për kryetar të komunës në Mitrovicën Veriore më 23 shkurt të vitit 2014 për t'i vëzhguar zgjedhjet komunale dhe për kryetar të komunave. Gjithsejtë ishin dislokuar 99 vëzhgues në mbarë Kosovën për ta vëzhguar tërë procesin zgjedhor. MBEVZ i përmbahet Deklaratës së Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve i nënshkruar në Kombeve të Bashkuara në tetor të vitit 2005.

*Versioni elektronik i raportit përfundimtar është në dispozicion në ueb faqen e Misionit*  
[www.eueom.eu/kosovo2013](http://www.eueom.eu/kosovo2013)

*Pyetjet e gazetarëve duhet t'i drejtohen Florence Marchal-it, Zyrtare për Media dhe Komunikim me Publikun, BE MVZ: +386 49 73 77 08, [florence.marchal@eueomkosovo2013.eu](mailto:florence.marchal@eueomkosovo2013.eu)*